

FEDERATA E SHAHUT E KOSOVËS

RREGULLORE PËR AFATIN KALIMTAR TË LOJTARËVE DHE REGJISTRIMIN E KLUBEVE

1. Kjo rregullore përcakton të drejtat dhe detyrimet e lojtarëve dhe klubeve të regjistruara në FSHK dhe procedurën për afatin kalimtar të lojtarëve në kohëzgjatjen **10 – 20.03.2018**.
2. Obligohen klubet e shahut që Listën e shahistëve me nënshkrime ta dorëzojnë tek Komisioni për regjistrim deri më **20.03.2018**.
3. Lista duhet të përmbajë : emrin mbiemrin, datën e lindjes, numrin e letërnjoftimit dhe nënshkrimin personal të shahistit.
4. Nëse shahisti nënshkruhet në dy ose më shumë lista, duhet të deklarohet me shkrim se për cilin klub do të luan ose do të dërgohet në Komision disiplinor dhe do të suspendohet nga të gjitha garat e vitit 2018 të organizuara nga FSHK.
5. Nëse nënshkrimi i lojtarit falsifikohet nga zyrtarët e ndonjërit klub, ai do të ndëshkohet me 2 vjet suspendim nga të gjitha aktivitetet e organizuara nga FSHK.
6. Kotizimi për ekipet e Ligës së parë është **350 €**, ndërsa për ekipet e Ligës së dytë **190 €**, në të cilën përfshihet edhe anëtarësia vjetore për 8 shahistë.
7. Lojtarë vendor do të konsiderohen të gjithë shahistët me nënshtetësi kosovare dhe ata që gjinden në FIDE ranglistë nën kodin e Kosovës.
8. Secili klub do të ketë të drejtë që në edicionin e garave të vitit 2018 ta ketë në ekip një lojtarë të huaj. (**Sqarim** : Në formacionin e zgjeruar mund të ketë më shumë por në ndeshje mund të aktivizohet vetëm një).
9. Pagesa bëhet në xhironlogarinë : **1501001001229761 në Raiffeisen Bank Prishtinë**.
10. Komisioni i regjistrimit obligohet që nga data **21 – 27.03.2018** të kontrollojë listën e shahistëve me nënshkrime të dorëzuar nga klubet e shahut dhe ato t'i publikojë në faqen e **chess-results.com**.
11. Rregullorja për afatin kalimtar vlen për garat ekipore për vitin 2018.

Komisioni : 1. Arben Bytyqi, 2. Burhanudin Misini, 3. Nuridin Hyseni

P.S. Vëni re! Asnjë klub nuk do t'i fillojë garat pa e bërë pagesën e kotizimit para fillimit të xhiros së parë. Arsyetimet se komuna ende nuk ua ka qitur mjetet e subvencioneve nuk do të mirren parasysh.